



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 dhjetor 2011
Nr. ref.: RK171/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI-96/10

Parashtrues

Nikollë Qetta

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev. nr. 361/2010, të 24 prillit 2010 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në
Pejë AC. Nr. 111/2010, të 16 qershorit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Nikollë Qetta, nga Gjakova, të cilin e përfaqëson avokati Franjo Pal Jankova, nga Prishtina.

Vendimet e kontestuara

2. Vendim i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës rev. nr. 361/2010, i datës 22 prill 2010, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 7 korrik 2010, me të cilin është refuzuar revizioni në këtë lëndë dhe janë vërtetuar vendimet e mëhershme të organeve të Gjykatës së Qarkut dhe asaj komunale në lidhje me çështjen e lëndës. Vendim i kontestuar është edhe Aktvendimi Gjykatës së Qarkut në Pejë AC. Nr. 111/2010, i datës 16 qershor 2010.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës rev. nr. 361/2010, i 22 prillit 2010 dhe Aktvendimi Gjykatës së Qarkut në Pejë AC. Nr. 111/2010, i datës 16 qershor 2010, me të cilat, sipas pohimeve të parashtruesit të kërkesës, i janë cenuar të drejtat nga marrëdhëniet pronësore, të drejta këto të garantuara me nenet 31, 46 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenet 1 dhe 6 të Konventës për të drejtat e njeriut (E drejta e mbrojtjes së pronës dhe e drejta për një proces të rregullt).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi i kërkesës, më 4 tetor 2010, ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
6. Më 15 nëntor 2010, Gjykata Kushtetuese e njoftoi z. Franjo Pal Jankovën dhe Gjykatën Supreme se është iniciuar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimit të tyre sipas revizionit Rev. Nr. 361/2007, të 22 prillit 2010.
7. Më 4 prill 2011, Gjykata kërkoi dokumente shtesë nga Komuna e Gjakovës –Drejtoria për çështje juridiko-pronësore e po ashtu edhe nga avokati Franjo Pal Jankova.
8. Më 19 prill 2011, duke u përgjigjur në shkresën e gjykatës, Komuna e Gjakovës në shkresën e saj 11 nr. 465-2528/11 ka paraqitur njohuritë e saj rreth objektit të çështjes dhe i dorëzoi gjykatës dokumentacionin shtesë.
9. Më 4 maj 2011, sipas kërkesës së gjykatës, avokati Franjo Pal Jankova e dorëzoi dokumentacionin shtesë.
10. Më 17 qershor 2011, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga Gjykata Komunale e Gjakovës dokumentacion shtesë dhe sqarim se në cilën fazë ka arritur çështja në këtë gjykatë.
11. Më 28 qershor 2011, Gjykata Komunale në Gjakovë ka paraqitur dokumentacionin shtesë dhe ka dhënë shpjegime se në cilën fazë të procedurës ka arritur çështja në këtë gjykatë.
12. Më 19 korrik 2011, Gjykata Kushtetuese ka kërkuar dokumentacion shtesë nga Gjykata e Qarkut në Pejë dhe sqarim se në cilën fazë ka arritur lënda në këtë gjykatë.

13. Më 5 gusht 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë ka paraqitur shkresat e lëndës dhe ka dhënë përgjigje se në cilën fazë ka arritur lënda në Gjykatën e Qarkut në Pejë.
14. Më 21 nëntor 2011, pas shqyrtimit të raportit, Gjyqtarit raportues Ivan Čukalović, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Snezhana Botusharova, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë që ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme.

**Përmbledhja e fakteve në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë
AC. Nr. 111/2010, të datës 16 qershor 2010**

15. Me Aktvendimin e Drejtorisë Komunale për Çështje Pronësore Juridike në Gjakovë nr. 19-465-7/1986, të 28 korrikut 1986, parashtruesit të kërkesës i është shpronësuar prona në ngastrën kadastrale nr. 5133/34, me kulturë shtëpi, me sipërfaqe prej 79 m2 dhe oborrin me sipërfaqe prej 400 m2.
16. Me propozimin e Avokatit publik, shpronësimi është kryer në të mirë të Komunës së Gjakovës për nevoja të BVI-së në fushën e banimit dhe veprimtarisë komunale dhe më qëllim të ndërtimit të rrugës “Kosta Novakovic” dhe të një rruge tjetër për troje.
17. Aktvendimi i Drejtorisë Komunale për çështje pronësore-juridike në Gjakovë nr. 19-465-7/1986, i 28 korrikut 1986, iu dërgua palëve në procedurë, kundër të cilit ato nuk ushtruan mjetet juridike të përcaktuara me ligj, kështu që ky aktvendim më 16 shtator 1986 u bë i plotfuqishëm dhe i përmbarueshëm dhe iu është dërguar organeve kompetente me qëllim të ndryshimit të pronësisë në librat kadastralë.
18. Brenda afatit të përcaktuar me ligj, Avokati publik në Komunën e Gjakovës, pas vlerësimit të objekteve të shpronësuar dhe vlerësimit të tokës, ka paraqitur ofertë në mënyrë që të arrijnë marrëveshje për kompensimin e patundshmërisë së shpronësuar.
19. Në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 1988 në Drejtorinë për çështje pronësore-juridike në Gjakovë, në praninë e të dyja palëve, nuk është arritur marrëveshje për kompensimin e patundshmërisë së shpronësuar.
20. Autoritetet komunale me aktin nr. 19 465-7/1986 të 11 tetorit 1988, përcjellin çështjen në Gjykatën Komunale të Gjakovës, në mënyrë që në procedurë jokontestimore të përcaktohet kompensimi i pronës së shpronësuar.
21. Më 3 nëntor 1988, në Gjykatën Komunale të Gjakovës me aktvendimin nr. v. 520/88 përcaktohet kompensimi për patundshmërinë e shpronësuar, dhe më 24 nëntor 1988 aktvendimin e merr e reja e parashtruesit të kërkesës, Valentina Jankopalli, e cila jeton në bashkësi familjare me parashtruesin e kërkesës.
22. Më 23 shkurt 2010, parashtruesi i kërkesës paraqet ankesë kundër vendimit të Gjykatës Komunale të Gjakovës v. nr. 520 /88, të 3 nëntorit 1988, duke pohuar që parashtruesi i kërkesës kurrë nuk e kishte marrë vendimin dhe që e reja e tij, Valentina Jankopalli, është person gjysmëanalfabet.
23. Më 16 qershor 2010, Gjykata e Qarkut në Pejë me Aktvendimin AC. nr. 111/2010 e hedh poshtë ankesën si të pabazuar dhe vërteton vendimin e Gjykatës Komunale të Gjakovës v. nr. 520/88, të 3 nëntorit 1988.
24. Ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës AC. nr. 111/2010, të 16 qershorit 2010, parashtruesi i kërkesës, më 22 korrik 2010 parashtron revizion në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës.

25. Lënda, sipas revizionit, nuk është përmbyllur dhe nga 6 shtatori 2010 gjendet në Gjykatën Supreme të Kosovës e cila vendos në lidhje me revizionin.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 361/2010, të 22 prillit 2010

26. Procedura në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë C. nr. 331/01, të 11 dhjetorit 2002, në të cilën Gjykata Komunale në Gjakovë pranon kërkesë-padinë e Musa Mirakajt dhe parashtruesin e kërkesës e obligon që të dorëzojë në posedim pjesën jugore të ngastrës kadastrale nr. 5133/33, të sipërfaqes së tërësishme prej 0.002,36 ha, dhe njëkohësisht obligon parashtruesin e kërkesës që të kompensojë shpenzimet procedurale prej 1.176,17 euro, nuk ka të bëjë me ngastrën 5133/34 por me ngastrën 5133/33, për të cilën parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar asnjë provë se nuk i është paguar kompensimi.

27. Po ashtu, procedurat ankimore sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. nr. 234/03, të 16 shkurtit 2007, ashtu sikurse edhe procedura sipas revizionit në Gjykatën Supreme të Kosovës - Aktgjykimi me nr. rev. 361/2007 i 22 prillit 2010 - në bazë të të cilave parashtruesi i kërkesës e mbështet kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, nuk kanë të bëjnë me ngastrën 5133/34 për të cilën procedura jokontestimore për përcaktimin e kompensimit në procedurën sipas revizionit është në vazhdim e sipër në Gjykatën Supreme të Kosovës, por kanë të bëjnë me ngastrën 5133/33 për të cilën parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar kurrfarë prova se nuk i është paguar kompensimi.

Pretendimet e parashtruesit të ankesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës nr. rev. 361/2010, të 24 prillit 2010, me të cilën është refuzuar revizioni në lidhje me këtë lëndë dhe janë vërtetuar vendimet e mëhershme të organeve komunale dhe gjyqësore në kontestin e kësaj lënde, i janë cenuar të drejtat në lëmin e marrëdhënieve pronësore, si dhe të drejtat e garantuara me nenet 31, 46, dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

29. Më tej, pohon se më këtë aktgjykim është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe e drejta për mbrojtjen e pronës të parapara me nenet 1 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila është pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës në lidhje me Aktvendimin e Gjykata së Qarkut në Pejë AC. Nr. 111/2010, të 16 qershorit 2010

30. Në mënyrë që të mund të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë që parashihen me Kushtetutë, si dhe me Ligj dhe Rregullore të punës. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 paragrafit 7 të Kushtetutës:

„ Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

31. Nga dokumentacioni i siguruar sipas kërkesës, rrjedh se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që i ka në dispozicion, pasi që revizioni që e ka paraqitur në procedurë jokontestimore për përcaktimin e kompensimit për ngastrën kadastrale 5133/34 ndaj aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë AC. nr. 111/2010 të 16 qershorit 2010, e cila është kërkesa thelbësore e parashtruesit të kërkesës, është ende në proces të

zgjdhjes në Gjykatën Supreme në Prishtinë, e regjistruar me numër NDR. 520/88, më 23 gusht 2010.

32. Gjykata konstaton se arsyetimi për të drejtën e shterjes së mjeteve juridike, ekziston që organeve kompetente, përfshirë gjykatat, t'u jepet mundësia që të parandalojnë dhe përmirësojnë shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Rregulli është bazuar në supozimin se rendi juridik në Kosovë do të sigurojë mjete efikase juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih *mutatis mutandis*, KEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, vendimi i 28 korrikut 1999).
33. Nga kjo rrjedh se kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë AC. Nr. 111/2010, të datës 16 qershor 2010, është e papranueshme për shqyrtim në pajtim me rregullin 36 (1a) të Rregullores së punës që parasheh se, "Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: a) janë shterur të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar."

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 361/2010, të datës 24 prill 2010

34. Parashtruesi i kërkesës thotë se neni 31 (e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), neni 46 (Mbrojtja e Pronës) dhe neni 53 (Interpretimi i Dispozitave të të Drejtave të Njeriut) i Kushtetutës së Kosovës, poashtu edhe neni 1 (Obligimi për të respektuar të drejtat e njeriut) dhe neni 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, janë bazë për kërkesën e tij.

35. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parasheh:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”

36. Në lidhje me kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 361/2010, të 24 prillit 2010, në bazë të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit kur shqyrtohen vendimet e marra nga ana e gjykatave të rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe të së drejtës materiale (shih *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut [ESLjP] 1999-I).
37. Parashtruesi i kërkesës nuk e ka dorëzuar asnjë provë *prima facie* që do të vërtetonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i KEDNJ në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99 të 31 majit 2005). Parashtruesi i kërkesës nuk saktëson se në çfarë mënyre nenet 31, 46 dhe 53 e mbështesin kërkesën e tij, ashtu siç parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.
38. Parashtruesi i kërkesës pohon se të drejtat e tij janë shkelur me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe me zbatimin e gabueshëm të ligjit nga ana e gjykatave të zakonshme, duke mos saktësuar në çfarë mënyre këto vendime ia kanë cenuar të drejtat e tij kushtetuese.
39. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i janë dhënë mundësi të shumta për të paraqitur rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit për të cilin konsideron që është i pasaktë, në Gjykatën Komunale të Qarkut dhe atë Supreme. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur se procedurat përkatëse, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituaniës,

vendimi i KEDNJ në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06 të 30 qershorit 2009).

40. Përfundimisht, kushtet për pranueshmëri nuk janë përmbushur në këtë kërkesë. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të saktësojë dhe të mbështesë me prova pretendimin se me vendimin e kontestuar i janë cenuar të drejtat dhe liritë kushtetuese.
41. Nga kjo del se kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 361/2010, të datës 24 prill 2010, është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës që parasheh: “Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese e Kosovës në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 (2) të Ligjit, si dhe rregullin 36 (1a) dhe 36 (2b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 21 nëntor 2011, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën në tërësi si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t’u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

